



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401649/7

Tiranë ___/___/2015

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave për ofrimin e shërbimit me kujdestarë në IEVP Krujë nga ora 22:00 deri në orën 07:30*

Drejtuar: Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve
Z. Artur ZOTO

TIRANË

Për dijeni: Drejtorit të IEVP Krujë
Z. Astrit BAKU

Zahari, KRUJË

I nderuar Z. Zoto,

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë regjistruar ankesat e familjarëve të të burgosurve S. D. dhe A. D., persona me aftësi të kufizuar. Ankuesit pretendonin se në IEVP Krujë, ku të afërmit e tyre vuanin dënimin, nuk ofrohej shërbim kujdestarie gjatë natës. Nga ora 22:00 deri në orën 07:30 në IEVP Krujë nuk kishte një person që tu vinte në ndihmë të burgosurve me aftësi të kufizuar për tu pastruar dhe ndërruar.

Për verifikimin e këtyre rasteve fillimisht i jemi drejtuar me një kërkesë për shpjegime IEVP Krujë. Në të dy rastet, IEVP Krujë na është përgjigjur si më poshtë vijon:

Në organikën e IEVP Krujë, të miratuar me Urdhërin Nr.50, datë 13.04.2012 të Kryeministrit, janë përcaktuar 3 kujdestarë dhe 5 sanitarë. 3 kujdestarët që shërbejnë për personat e pamundur janë të planizuar të punojnë në një hark kohor prej 16 orësh. Ndërsa sanitarët nuk mund të shërbejnë për të burgosurit e pamundur për dy arsye: ato janë femra dhe nuk mund të pastrojnë të dënuarit dhe orari i tyre i punës i miratuar është nga ora 08:00 deri në orën 16:30. Për këto arsye koha nga ora 22:00 deri në orën 07:30 nuk mund të mbulohet me shërbim kujdestar.

Më pas iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me një shkresë ku kërkuam të viheshim në dijeni nëse: ishte menduar ndonjë zgjidhje

për ofrimin e shërbimit me kujdestarë në IEVP Krujë nga ora 22:00 deri në orën 07:30 dhe nëse ishte propozuar shtim i organikës në IEVP Krujë?

Në përgjigjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve thuhet se, stafi prej 3 kujdestarë dhe 5 sanitarë është i mjaftueshëm për dhënien e shërbimit të kujdestarisë në IEVP Krujë. Institucioni ka për detyrë ta ofrojë këtë shërbim 24 orë.

Megjithëse Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve shprehet se është detyrë e IEVP Krujë për të ofruar shërbim me kujdestarë gjatë 24 orëve për të burgosurit me aftësi të kufizuar, ky shërbim nuk ofrohet nga ora 22:00 deri në orën 07:30 për arsyet e lartpërmendura.

IEVP Krujë është i kategorizuar si institucion i veçantë ku ka një seksion për të burgosur me aftësi të kufizuar. Sipas nenit 5 të ligjit nr.8328, date 16.04.1998 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burg dhe të paraburgosurve*", i ndryshuar, të paraburgosurve dhe të dënuarve me aftësi të kufizuar duhet tu plotësohen nevojat specifike për aftësimin dhe riaftësimin e tyre.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut*" si dhe në mbështetje të nenit 21/c të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*" i ndryshuar ku përcaktohet se: "*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen.*"

J U R E K O M A N D O J M Ë:

Marrjen e masave për ofrimin e shërbimit me kujdestarë në IEVP Krujë nga ora 22:00 deri në orën 07:30.

Në bazë të nenit 22 të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R

Arben SHKËMBI